



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBER  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM NR 78 Datë 28.05.2020

**“Për përdorimin e fondit nga transfertat e World Vision dhe bashkëfinancimi i Bashkisë Diber për financimin e projektit Tungjatjeta Jete”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjit nr.88/2019 datë 18.02.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Diber nr.140 datë 26.12.2019, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Diber me vendimin , nr.16/1 prot. datë 17.01.2020: Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij, datë 28.05.2020 me 18 vota pro 3 vota kundër.

**VENDOSI :**

- I. Në bazë të vijimësisë së marrëveshjes së bashkëpunimit për financimin e projektit “Tungjatjeta Jete” midis Bashkisë Diber dhe financimit të projektit “Tungjatjeta Jete” World Vision e cila do të miratohet në Këshillin Bashkiak Diber kërkojmë miratimin e këtij projekt-propozimi të shtohet buxhetit të Bashkisë Diber, me kontribut të World Vision 3.772.000 lekë dhe bashkëfinancimin e Bashkisë Diber me vlerë 500.000 lekë.
- II. Kjo marrëveshje është 1- vjecare dhe pagesa do llogaritet që në muajin Maj 2020 me personelin aktual të marrëveshjes së mëparëshme. Ndryshimet që janë bërë në buxhetin e vitit 2020 janë bërë nga muaji Maj – Dhjetor 2020. Nga llogaritjet për shpenzimet mujore totale për paga dhe sigurime janë në vlerën 356.000 lekë, llogaritjet për 8 muaj janë në vlerën 2.848.000 nga të cilat  $8 \times 314.333 = 2.514.664$  do jenë kontribut i World Vision dhe  $8 \times 41.667 = 333.333$  lekë do të jenë kontribut i bashkëfinancimit të bashkisë nga këto shpenzimet për llogarinë ekonomike 600 janë 2.440.440 lekë dhe për llogarinë ekonomike 601 janë 407.550 lekë diferenca prej 1.424.000 lekë do meret parasysh në buxhetin e vitit 2021.
- III. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Personelit dhe Sektori i Financës pranë Bashkisë Diber.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmeri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Diber.

Sekretare Keshilli

Inva Trupja

Kryetar Keshilli

Sokol Sava

